



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	14.05.2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	“ ICT for Kosovo growth”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga “ ICT for Kosovo growth” me të cilën kërkohet që me datë 29 Qershor 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti” (Amfiteatër).

Qëllimi i projektit është të përmbushë mungesat për shkathtësi digjitale e bizneseve në mënyrë të qëndrueshme duke plotësuar nevojat e tregut si dhe të mbështet nxitjen e konkurrueshmërisë së bizneseve kosovare digjitale dhe tradicionale duke përkrahur rritjen e sektorit të ICT në Kosovë e cila do të sjellë rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti”(Amfiteatër) me datë 29 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

**Kushtet e pëlqimit:**

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.